



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË FIER TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "DEMOKRACIA E RE EUROPIANE" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Fier të depozituara nga Partia "Demokracia e Re Europiane" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Demokracia E Re Europiane", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia "Demokracia e Re Europiane", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia "Demokracia e Re Europiane" ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.



Nr. 557 i Vendimit

Data 18.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Vlorë të depozituara nga Partia "Fryma e Re Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në mbledhjen e datës 18.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Partisë Demokratice e Re Europiane dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Vërtetim për zotërimin e mandatit në Kuvend sipas sipas nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar/Listën e zgjedhësve që mbështesin partinë/koalicionin;
2. Numrin e nevojshëm të kandidatëve në listë sipas nenit 67 pika 5;
3. Nuk është respektuar kuota gjinore në listën shumëmemërore Model 10 K;
4. Deklarimi i kuotës gjinore i plotësuar jo sipas shpërndarjes së gjinisë;

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga Partia Demokratice e Re Europiane.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Bashkisë Fier, të Partisë Partia Demokratice e Re Europiane për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 557 i Vendimit

Data 18.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Vlorë të depozituara nga Partia "Fryma e Re Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019